



Presidenti i Mamurrasit është shpallur në kerkim nga policia për ngjarjet e dhunshme për menjehere Dede Ndreca ka sqaruar pozicionin e tij dhe ka thënë se nuk e ka goditur por e ka mbrojtur gjyqtarin Zhuli nga dhuna e tifozëve. “Tani e mora vesh se qenkam i kerkuar. Isha në kafe me miqte e mi, se sapo jam kthyer nga jashtë dhe me thanë. U çudita. Tani jam në familjen time dhe në shtëpinë time dhe nuk jam fshehur fare. Ka pasur incident pas ndeshjes. Une kam qene në lokal në momentin që kanë shkuar të dhunojnë arbitrin. Jam ngritur nga lokali dhe kam shkuar e kam larguar njëzërit që e kishin rrethuar. Une di që e shpetova gjyqtarin të mos goditej. Megjithatë une jam i gatshëm të përballem me këdo, edhe me atë në gjykatë, policia dhe ku të dojë ai. S`jam njeri i dhunës dhe s`mund të ia lejojë vetes të goditet një gjyqtar në zonën time. Këtu jam dhe jam i gatshëm të përballem me drejtësinë”, ka thënë Deda.